



**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË**  
 SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA  
 MUNICIPALITY OF SUHAREKA



**PROCESVERBAL VII/2018**

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së VII (shtatë) të rregullt për vitin 2018 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

**Vendi:** Suharekë  
**Zyra:** Salla e Kuvendit të Komunës  
**Data:** 27.06.2018  
**Ora :** 13.00

**Prezentë në takim:**

|                     |                     |  |
|---------------------|---------------------|--|
| z. Nexhat Ramadani  | z. Rilind Krasniqi  | Të pranishëm të tjerë<br>Kryetari Komunës<br>Medjat dhe qytetart<br>OSCE, LMT, KDI<br>Habibe Bytyqi<br>Xheladin Sadikaj, etj |
| z. Bashkim Ndrecaj  | z. Jeton Rakaqi     |  |
| z. Ardian Shala     | z. Arbërim Basha    |  |
| z. Alban Berisha    | z. Dardan Berisha   |  |
| z. Shefket Kolgeci  | znj. Marigona Gashi |  |
| z. Xhemajl Kabashaj | znj. Florie Bytyqi  |  |
| znj. Elmaze Bytyqi  | z. Sami Hajdari -   |  |
| znj. Bulëza Kuçi    | znj. Albana Bytyqi  |  |
| znj. Shqipe Ramaj   | z. Osman Selimaj    |  |
| z. Sali Bytyqi      | z. Leonard Shala    |  |
| z. Reshat Selimaj   | z. Dugagjin Palushi |  |
| z. Shefket Kuçi     | znj. Laureta Tafaj  |  |
| z. Bexhet Kuçi      | z. Gëzim Kryeziu    |  |
| z. Aziz Bytyqi      | -----               |  |
| z. Gazmend Gashi    |                     |  |
| znj. Besa Kuçi      |                     |  |
| znj. Mirlinda Muqa  |                     |  |
| znj. Vlora Neziri   |                     |  |

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

### Rend dite

1. **Miratimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafostacioneve dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2019-2021;**
4. **Shqyrtimi i project rregullores për rregullat e punës në instiucionet shkollore për stafin udhëheqës mësimdhënës,nxënës dhe stafin mbështetës;**
5. **Pyetje dhe përgjigje;**

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi

**Kryesuesi** - i përshëndeti të pranishmit, njofton për rendin e ditës kërkoi të votohet.

**Aprovohet**

**Pika e parë - Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar**

**Aprovohet**

**Pika e dytë- Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafostacioneve dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Kryesusi** – njofton për pikën e dytë dhe njofton për kërkesën e parashtruar drejtorisë për shërbime pronësore dhe kadastër.

**Florije Bytyqi**-Ne si grup parlamentar jemi pro këtij projekt vendimi ,arsyeja pse jemi pro këtij projekt vendimi është se përfitojnë banorët e asaj ane ,kanë furnizim më të mirë të rrymës elektrike do të ken mundësin për furnizim të rrymës elektrike edhe aparaturat e amvisnisë në gjdo sezon,mirëpo jam në dyshime a është e mjaftueshme vetëm një traf ,a ka kërkesa edhe për ndonjë traf tjetër nëse po është mirë menjëherë t'a aprovojmë

**Kryetari**–përshëndet të pranishmit ,kjo është programi i Kekut që e ka parapa vitin e kaluar për këtë vit ,është e paraparë në Nishor,Studenqan ,Budakovë,kemi bë kërkesa dhe për vitin e ardhshëm ,ka edhe vende tjera që kanë nevojë për vendosjen e trafave mirëpo po fillojm njëhr me këto trija pastaj shohim viti e ardhshem qka mundemi me bo .

**Leonard Shala**-Përshëndetje ,une mendojë kryetarë që është momenti që ju me kërku nga kompania KED-s ,me pas parasysh me hartu një plan të përbashkët ,që i bije nese ne japim pronën në shfrytëzim pa asnjë interes atëher ne atë plan të paktën të parashihi disa investime ,përveç asaj që ata thirrën që investimet të shkojnë në shfrytëzim më të mirë më energji ,duhet me pas investime prsh të karakterit investime publik,investimi i KEDSit është interes i kompanisë private ,ndërsa investimet sipas kërkeses së komunës janë investime që behën për komunitetin dhe si shpërblim ,krijojnë mundësin që komuna pa kosto financiare po ja jep në shfrytëzim pronën komunale kërkon nga kryetari me insistua me kriju një plan të përbashkët në mënyrë që edhe na të përfitojmë diçka .

**Bashkim Ndrecaj**-përshëndetje, në emër të grupit të asamblistëve të LDK-së e përkrahim këtë , në e kam një kërkesë për drejtorin e urbanizmit kur t ju vini kërkesat për leje ndërtimore prej KEDS-it ,a ju vinë me specifikacion se qka ka mu vendos dmth në këtë rast a ka me u vendos traf shtyll ktu apo traf blind, dhe nëse na jau ndajmë parcelën mos ka me pas ndonjëherë rrugë aty që munët me na pengu .

**Avni Bytyqi**- bashkimi e ngriti një çështje që ndoshta është deshtë me u diskutu mirëpo nëse e keni lexuar vendimin me vëmendje nenin 3 pika l thotë decitivisht se kurdoherë komuna që ka nevojë për atë lokacion e ka të drejtën e ndryshimit të lokacionit për interes të përgjithshëm .

**Aprovohet**

### **Pika e tretë- Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2019-2021;**

**Kryesuesi**-njofton për pikën e tretë

**Dardan Berisha**-kamë disa vërejtje në specifikim prsh disa fshatra nuk janë specifiku se cilat rrugë do të ndërtohen në Gjinoc ,Nishor ,Dubravë të specifikohën se cilat rrug do të ndërtohen , tek Kultura rinia sporti dhe mërgata ndërtimi dhe renovimi i objekteve sportive dhe këtu të specifikohën se cilat rrugë.

**Jeton Rraqaqi**-edhe ne si grup parlamentar i kemi vërejtjet tona ,prsh nuk kamë pa që janë nda mjete për rregullimin e rrugës së Reqanit qe në reshjet e fundit uji ju ka hy në shtëpi ,kisha thënë që ma mirë me lanë ndonjë projekt tjetër mangu e me zgjidh problemin e asaj rruge. Nën 2 e kemi pasi dhe mjete janë ndarë për ceremoninë mortore në emër të grupit parlamentarë jua drejtojmë një kërkesë të gjitha ceremonitë mortore përgjegjësit kryhen nga komuna në forma ose në bashkëpunim me bashkësinë Islame të Kosovës,problem tjetër janë nda mjete për rrënim se di pse i ndani këto mjete kur në Suharekë kjo s'ka ndodhë kurrë në fshatin tim nuk janë specifiku të gjitha rrugët që kemi bë kërkesë prej të gjithë grupit vetëm mu me ke ftu në Gelancë dhe pse nuk janë specifiku të gjitha rrugët që kemi bërë kërkesë janë shtu disa tjera të cilat nuk jemi marrë veshë si kryesi e fshatit për ndërtimin e tyre,dhe është mire me i ftu edhe anëtarë tjerë me kontribuo dhe këta në vendet nga cilët vijjnë. Ne do ta miratojmë me kusht që deri në shtator të gjitha rrugët të specifikohen dhe kërkesat tona ti keni parasysht.

**Kryetari**-jep përgjigjej Dradanit ,dhe më tutje janë disa rrugë që nuk janë të vendosura emrat ,dhe e dini që masi e kem aprovua buxhetin bashkë kemi hek 10% e projekteve ,dhe po na ndodhë me këto fazat e fundit që kem fillu me punu gjdo kun ka mbetje ,do të mundohemi deri në shtator me l specifiku të gjitha rugët ,te rruga reqanit me të vërtet është problem por deri sa nuk gjejmë ekspert Professional që na jep garancion që kjo punë nuk ka me u përsërit me ne një afat kohor,te ceremonia vorimeve ne kemi parapa këtë vit mjetet që në të ardhmen ta kem një bashkëpunim me bashkesin islame ,kjo është kornizë nuk është vendim .

**Ardia Shala**-i përshëndet të pranishmit,kjo kornizë ka ulje te projektet kapitale ,shpenzime më shumë për administratë ,veq në drejtorinë e shërbimeve publike kemi rritje nga 50.000 sa kan qenë në vitin 2018,për mallra shërbime ngritje në 640 mijë në vitin 2019 që i bjen diku 13 herë më shume ,gjithashtu dhe ne QKMF nga 218mije prej mallrave shërbimeve në 425 mije apo dy herë me teper se ne vitin e kaluar te projektet kapitale kemi mospecifikim të projekteve në disa vendbanime është Leshani ,Breshanca ,Greqjevci ,Luzhnica ,Maqiteva ,Nëpërbishti ,Dolloci etj me asnjë cent investim ndërsa në disa

vendbanime sic është Gjinoci dhe Terrnja me nga 225 mijë euro , me siguri këtu mund me pas implikime politike gjithastu në Grjekoc kanë probleme me ujë,si dhe parashtron disa pyetje;në shumë vendbanime keni projekte rreth trotuarë të gjitha janë të paspecifikuara po ashtu një projekt të veçanët që kamë parë aty është ndërtim trotuarësh a është ky ni projekt që nëse dikush do të del i paknaqur do ta miratoni apo në qfar cilsie keni parashikuar këtë projekt,qka përmban dhe qka përfshin projekti rregullim i lumenjëve a është ndërtim i shtratit apo vetëm pastrim momental i lumenjve ,ku dhe si është menduar qendra për qëndrim ditore për të moshuarit ,projekti kamerave në qytet cili është autoriteti që duhet me i mbikëqyrë këto kamera dhe pse te drejtoria e shëndetësisë anashkalohet sidomos për projekt buxhetin shpenzimet kapitale kur janë në pyetje mos ti menaxhojë kjo drejtori dhe ni pyetje për drejtorinë e financave nëse ka mundësi 2018 si ka rrjedh alokimi mjeteve.

**Kryetari**-jemi duke u mundu mos me bo gabime,shumë shpejt ka me ardh edhe raporti auditorit mei dobtu i mundshëm ,vetëm dy projekte dmth për këtë vit dhe vitin e kaluar ,që janë 400mijë euro në vlerë marrën prej investimeve kapitale dhe shkojnë në mallra dhe shërbime ,por këtë vit jemi marrë vesh ,do ta propozojm ministrisë së financave me ndryshu tavani sa është limiti ,sa i përket ujit të grejkocit përgjegjësit ka me i marr hidroregjioni sepse është kompani publike ,dhe paguhët për atë pun ,qka kem mundësi ne kem me i ndihmu ,mirëpo është përgjegjësi e hidroregjionit,sa i përket pastrimit të lumënjëve kemi më fillu në gjitha fshatrat ,mjetet që jan të parapara do të shfrytzohen ku ka probleme me shumë ,për mirëmbajtjen e trotuarëve vitin e aardhshem kam palnifikun 100mijë euro për mirëmbajtjen e gjith trotuarëve jo vetem në qytet pore dhe fshatra ku ka nevojë ,sa i përket qendres ditore për qëndrim ka ardh koha të moshuarvë të jau siguru një vendqëndrim në muajin korrik do të mirremi me objektet që jan pron komunale që nuk kan pagu që 18 vite, kemi me vazhdu me i përfundu të gjitha rrugët që janë lën në gjyst.

**Sami Hajdaraj**-fshatrat që nuk janë përfshijë në projekte është mirë me u përfshijë.

**Rilind Krasniqi**-ngritë një qështje shumë specifike për studenqanin e dimë kryetar që buxheti për vitin 2018 është votu me tvetmin ndryshim për qështjën r rregullimit të rrugës " Kosova" ,kërkon sqarime për afatin kohorë te fillimit të rregullimit të kësaj rrugë,

**Kryetari**- do të vazhdojmë më punu bashkë ,është bër një lëshim në atë kohë për rregullimin e kësaj rruge ,është ë vërtet që është shpall tenderi për rruget lokale në fshatin Studenqan ,kemi me i vazhdu rrugët të cialt kan mbet ngjyst kemi me vazhdu atë rrug ,është ë pamundur për sivjet me perfundu sepse nuk mjaftojnë mjetët të cilat jan parapa për sivjet për përfundimin e asaj rruge ,ndëersa rruga që e lidh studenqanin me zon industriale kemi me u mundu përmes ministris me siguru për arsye se kushton shumë.

**Leonard Shala**-përsëhendetje ,kjo kornizë është pothuajse e njejta për vite me radhë po vazhdon të ndahën shumica e mjeteve për infrastrukturë jo se nuk kemi nevojë për to por po që pothuajse që 20 vjet në përfundimin e luftës ne ende nuk kemi një plan të qart për zhvillim ekonomik ,nuk ka një planë për zhvillimin e kuadrave dhe mbështjetje për to ,është ë pa pranushme që deri më tani mos tkemi një plan afatgjatë për zhvillimin e agroturizmit malor dhe të tjera kur ne si komunë kemi një pozit dhe me një plan konkret dhe me investime të mjaftueshme do të mund të arrinim rezultate të kënaqshme, gjithashtu do të duhët të ishte në plan dhe prioritet përvëq qytetin e therandës në mënyrë që të kemi sa më shumë vizitor e turist që të viziojnë qytqtijn tonë, kjo do të nënkuptonte të ardhura më shumë për biznese të vogla dhe të mesme ,kemi trashëgimi të majftueshme arkeologjike ,pozitë shumë të mirë gjeografikë të cilat të gjitha do të inkorporoheshin në një plan konkret dhe kështu dal nga dal të rritej mireqenia dhe punësimi për qytetarët.,nuk duhët të harrojme dhe gjendjen e rënde të atyre më të

moshuarvë ,pensionistëv,të cilët nuk kanë asnjë vend ku të kalojnë kohën ,megjithatë me të gjitha vërejtjet që i dhash unë do ta mbështes këtë projekt-vendim për miratimin e kornizës afatmesme .

**Mirlinda Muqa**-kryesuese e grupit të grave ,nga mbledhja e mbajtur me grat asambleiste kemi vendosur të kërkojmë hapjen e një qerdhe publike nga ana e komunës.

**Kryetari**-sa i përket kamerave të sigurisë ,komuna ka me i vendos po mbiqyrjen e merr policia ,ndërsa edhe për qerdhe tregon që kanë plane për rregullimin e qerdhës. Gjithashtu kam dergu dhe 4 projekte tash për me planifiku për vitin e ardhshëm në ministrin e infrastrukturës ,2 janë rregullimi i unazave ,njera nga pjesa e damperit deri në biraq dhe tjetra të zona industriale si dhe rregullimi i dy rrugëve lagjja e Buqve dhe rregullimi rrugës që fillon në fshatin Baqevc mu lidh me Korishë.

**Nexhat Ramadani**-përshëndet të pranishmit,pjesa për të cilën kisha diskutu është pikërisht qështja për mallra dhe shërbime ,kemi bisedu dhe në komitetin për politik dhe financa ,jemi për kërkesën e kryetarit që këto po konsiderohen si keqklasifikim të jet e mundur të bartën të mallrat dhe shërbimet ,kët kërkes e kemi ba zyrtarit financiar por gjithmonë qeveria na ka kthyer negativisht, ne prap kërkojmë që nëse ka mundësi që ato të dërgohen atje dhe në raport të auditorit pa marr parasyh cila qeveri është mos tdel keq raporti,si dhe kërkon sqarim nga drejtori i shërbimeve publike se cilat janë projektet që janë konsideru si mallra dhe shërbime që janë bart prej kategorisë së investimeve kapitale tek mallrat dhe shërbimet si dhe kam dhënë vërejtje dhe në kornizën që kemi pas në KPF ju përpos kësaj rritje kemi pas rritje të mallrave dhe shërbimeve shume dmth vetëm të drejtoria shërbimeve publike kemi pas rritje për 56 mij euro rritje të mallrave dhe shërbimevev unë po mëndo që kjo rritje kaq e madhe vetëm të kjo drejtori nuk besojë që është e arsyeshme ,

tjetra e pyes drejtorin e shërbimeve publike ose kryetarin a mundën me na dhan sqarime se cilat janë ndryshimet të korniza afatmesem buxhetore 2018-2020 cilat janë projektet që kemi i nryshu dhe nuk kemi marre përgjigje , sa kemi pa unë kaa shume pa ndryshime që më jep me kupt që ju skeni punu hiq në këtë korniz dhe kryesroja që është është mos specifikimi projekteve ,ne do ta votojmë me qëllimin më të mirë që do të permisohet në të ardhmën.

**Kryetari**- rruga studenqanit është vendos në mënyr publike ,jemi tu vepru qysh asht vendos në asamble jo qysh po dëshirojm ne ,e pyet Nexhatin qka kemi ba me rrugen e cila ka qenë në projektin e juaj që ka ndryshu në paramasa ,nuk ka pas mure mbrojtse i kemi bërë muret mbrojtës pa dokument,ky buxhet për këtë vit është i juaj e patëm zvoglu për 10%po përsëri mjetet kanë tepër ,është shume problem me bërë analiz dhe me dit sakt rruga Gjinoc-Dubrav sa do të kushton ,kemi me i pas të gjitha rrugët e spëcifikune ato qka mëndojmë ,kemi me dal ekipet me i marr informtata për secilen ,kemi me u përfundu shumica ,ndërsa sa i përket kornizës në nuk mundemi me ndryshu për vitin 2020-2021 ne i kemi dhënë simendime tona sepse duhet me i shiku të gjitha fshatrat me i nda në mënyr të barabarta.

**Fadil Hoxha** – jep sqarime për rritjen e mallrave dhe shërbimeve dhe zvoglimin e projekteve kapitale.

**Laureta Tafaj** –kërkesa e qytetarëve në Bukosh ka qen me 5 rrioritete ju vetëm një e kemi aprovu.

**Florije Bytyqi**- replikon Nexhat Ramadani dhe ju kur kemi qenë në qeveri jukam kritiku se ska pas specifikim të projekteve,jam pro kësaj kornize por dua ta di për problemin e fshatit Nishor ,kanë probolem me ujë të pijshëm që është problem jetik a kemi mendu diqka rreth këtij problemi dhe tjetra kemi parë që ka rprojekte për rrugët lokale kisha pasë dëshir të jët rrioritet rruga e bullakve dhe një rrugë tjetër që lidhën me rrugë kryesore Nishor-

Bellanicë pastaj kisha pas dëshirë një projekt për kanalizimin e fshatit Nishor ,me dukët që ska fare dhe se di ae keni marrë për baz kanalizimin afër shkollës mendojë që është emergjente rregullimi i atij kanalizimi si dhe rruga ish në projekt Breshanc-Kosterrc ,si do të ndërtohet ajo rrugë si dhe për fshatin Leshan po flas ishin do ptojekte për rrug lokale nuk ishin të specifikuara rrugët si dh diskuton qështjen e qëndrimit ditor të pleq, për ndërtim objektit .

**Kryetari**-rrugët për Nishor-Bellanci ,Bullakve janë duke u punu ,besoj se do të përfundoj ,sa i përket kanalizimit ,është ni probleu privat ms dy familjevë ,nuk po dojnë më lan me kalu kanalizimin në atë pjes ,sa i përket ujit para 3 dite jam taku me hidroregjionin ,kan me shku me verifiku sa ka ujë për 72or ,nëse funksionin besojë që kem me fillu me ujsjellsin,ndërsa rruga Kastërrc-Breshanc besoj se duhët me kan e fundit pasi këto fshatra i kan prioritetet ,ka me u bë me zhavor për arsye se është problem me u mirëmbajt ,nëse kem buxhët pse jo edhe asfalt.

**Shefket Kolgeci**-përshendet të pranishmit –kamë vërejtje sepse për vitn 2019 është parapa pak mjete për fshatin Vraniq,dhe propozojë që për vitin 2019 të shtohen 20.000 euro për rregullimin e kanalizimit në këtë fshat,te rregullojmë këtë problem deri në fund si dhe kërkon 15.000 euro për rregullimin e ujsjellësit për këtë vend.

**Vlora Neziri**- po fokusohem te “Arsimi dhe Shkenca” ,ndërtimi dhe meremetimi i shkollave në komunë ,nuk janë të specifikuara se cilat shkolla do të meremetohen .Unë po ndalem te shkolla fillore 7 marsi është në gjendje të mjerueshme duke filluar nga inventari (sota pata rasttin me degju suksesin e fëmijëve tabelat janë katastrofale ,gjithashtu kisha propozu të shohët një aneks pasi është shumë i nevojshëm.

**Gëzim Kryeziu**-përshendet të pranishmit,Rruga Reqanit është në gjendje katastrofe ,dhe sa i përket ekspertëve mbrenda 30 dite jamë në gjendje me ta pru planin proeiktues,ndërsa po më intereson me dit qka është tu ndodhë me atë objekt te Shkolla Destan Bajraktari pse është ozurpu aj vend ,pasi aty është parapa ndërtimi i një qerdheje .

**Vlora Neziri**-kërkon rregullimin e ashnesorit te banesa kulla, kamë bë kërkkes dhe nga qeveria kaluar me kan thën jo ,në banesen ton ka gra të moshuara ,gra të dëshmorëve si dhe gra të diagnosifikuara me kancer .

**Bashkim Ndrecaj**-kamë nje kërkes Kryetar për Maqitev për 2019 nuk është parapa asnjë investim ,kamë një kërkes për rrugën Shaban Nuha që është e pakalushme ,diku rreth 180 metra si dhe te lagjja Bogve është von me intervenu në vitin 2020 kërkoj të planifikohët për vitin 2019.

**Kryetari**-te Lagjja Bogve janë të parapara 20mijë euro për rregullimin e asaj rruge ,mirëpo do të mundohemi me kry me ministrin këtë qështje,dhe ne Maqitev e kem plan kem me kry ate rrug ,ndërsa sa i përket liftit edhe un e përkrah këtë ide mirëpo është mirë më i kry të gjitha liftat pa dallime.

**Unanimisht Aporovohet**

**Pika katërt- Shqyrtimi i project rregullores për rregullat e punës në instiucionet shkollore për stafin udhëheqës mësimdhënës,nxënës dhe stafin mbështetës;**

**Kryesuesi**-prezanton pikën e katërt.

**Dradan Berisha**- Në emër të grupit parlamentar të PDK-së e mbështesim këtë projekt rregullorë ,e cila është më e e kompletuar nga rregullorët e mëparshme dhe lexon disa pika që janë bë ndryshime në këtë rregullorë prsh

ndarja e fondit të orëve ,kodi ose standardi veshjes nuk ka qenë,konkursi për vendët e punës ,ndarja e shpërblimëve për nxënës dhe mësimdhënës ,ndryshimi i rregullorës për ndarjen e bursave ,masat ndëshkuese për mësimdhënës ,ndryshimi në or për mësimdhënësit parafillor dhe mësimi shtes i obliguar,këto janë disa pika që janë bërë disa ndryshime prej vitit 2013, si dhe kërkon nga kolegët që ta votojnë.

**Alban Berisha** – përshëndetje, unë nuk do të lëshohem në substancën e kësaj rregullore pasi që nuk jam ekspert i arsimit po mendoj që kjo rregullore me 60 e më shumë faqe që ta jep përshtypjen se është një akt legjislativ,faktikisht rregullorja e rregullon një fushë të caktuar,qëllimi është shumë konfuz ku udhëzimi administrativ thotë që gjdo akt duhet me qenë më i shkurt ,ktu koncizitet nuk ka ,është shumë e gjatë rregulloja ,e përkrahë por kërkojë që kjo rregullore të shkurtohet dhe të analizohet edhe njëherë në mënyrë që MAPL mos të na kthejë për ligjshmëri por për standartizim.

**Dardan Berisha** – thashë që kjo rregullore është bazu në baz të udhëzimeve administrative ka shumë pika të cilat vetem janë shtu ,mirë është me u studi mirë .

**Ardian Shala** – ne e kemi pas një rregullore dhe po mundohemi të bëjmë disa plotësime ndryshime ,nuk po shoh diçka krejt të re dhe jep i jep vrejtyje disa pikave që kanë futur në rregullore.

**Aziz Bytyqi-i** drejtohet Ardian Shales ,po me vjen keq që nuk paskeni qenë të informuar për procedurat si kanë vijuar kurse në komision ka qenë dhe antarja e grupit të juaj dhe në këtë rregullore janë përfshij ekspert të DKA-së ,mësimdhënës dhe njerz të partive politike të cilën kanë qasje në fushën e arsimit ,ka pas debate publike në gjdo shkollë sa i përket kësaj projekti rregullorje ,kemi majtë 8 seanca ka qenë një vendim i kryetarit ku janë përfshijë përfaqësues të partive politike ka qenë Lauretë ,Dardani Unë dhe disa drejtorë të shkollave,kjo është një rregullore krejtësisht e re skemë bë plotësime të rregullorës së mëparshme.

**Gëzim Kryeziu-** i përgëzoj ata që kanë punë këtë rregullore ,është një rregullore shumë e mirë për mendimin tim, si dhe me pëlqej vendimet për punësim e psikologëve dhe pedagogëve nëpër shkollë ,mirëpo duke ditë që ka rregullativë e numrit të nxënësve si do të mundemi me i marrë këta psikolog ,ku ne kemi tepër në anën profesionale të profesorëve, si do të paguajmë ata.

**Lauretë Tafaj-** jemi për punësimin e psikologëve, janë shumë të nevojshëm në shkollat tona.

**Leonard Shala** –përgjegjësisht është përshkrim i udhëzimeve të cilat janë në fuqi por problemi është se sa do të zbatohet dhe sa ka komuna kapaciteti dhe vullnet për zbatimin e tyre .

**Besa Kuci**-përshëndes iniciativën e punësimin të psikologëve dihet se është shumë e nevojshme ,kërkojë që të vendoset një pikë që të ruhet konfidencialiteti psikolog-nxënës.

**Rilind Krasniqi**-pyet kryetarin për nenin 20 ,ku thotë udhëheqja e shkollave drejtorit zv drejtorit dhe administratorit ,thotë se drejtori zgjidhet sipas konkursit nga drejtorja komunale e arsimit ,ndërsa kryetari ka thënë se drejtorat do të zgjedhë këshilli i prindërve ,është mirë me sqarë këtë çështje.

**Kryetari**-asnjë kryetar nuk pretendon me shkel ligjin kuptohet që kryetari e zbaton ligjin që është në fuqi dhe bashkëpunon me bordin e prindërve dhe zgjidhet një person.

**Vlora Neziri** –paraqet një kërkesë të kryetari ,kur mund të parashihet që një shkollë të paktën të punojë me orarë 8 orë ,kisha propozim që ta kemi një të tillë nëse nuk janë kushtet edhe me participim të prindërve pasi që është shumë e nevojshme sidomos në familjet që punojnë dy prindërit.

**Kryetari**-ne nuk mundemi me al jashtë ligjit edhe pse punohet rregullorja ,këtë nuk mundet me vendosë drejtori arsimit as rregullorja kjo ka të bëjë me ligjet që janë në fuqi .

**Xhemajli Kabashi**- përshëndes komisionin për këtë punë që është ka bo,kamë prit me diçka më shumë reth regjistrimit të nxënësve ,sidomos në klasën e I0 ,kamë prit që këto ligje të përshtaten me këtë rregullore që t'i inkurajojnë që edhe nxënës të mirë të regjistrohen në teknik dhe në shkollën Skender Luarasi.

**Salih Bytyqi**-kjo është një rregullore që duhet të votohet se është mirë ,kërkojë që gjdo rregullore të votohet sepse gjdo njëra është në rregull.

**Florije Bytyqi**-përshendes komisionin për punën që ë ka ba ,kisha pas një vërejtje për rregullorën në fletën e parë n ballin të jët komuna e suharekës.

**Alban Berisha** – sipas teje doktorrr qka do që është të votojmë ,nëse ti po thu gjdo rregullore që të vjen atëher ka egzistu rregullorja pse ka pas nevoj mu mundu me bo një tjetër.

**Aprovohet  
23-për 2-kundër**

**Pika pestë- Pyetje dhe përgjigje;**

**Shefket Kolgeci**-jemi gjithë dëshmitarë të festave tona shtetërore e kam një sugjerim prej qytetarëvei ,informimi nuk është i duhur për vendndodhjen e vazrrezave të dëshmorëve kërkojë që kryetari të merr vendim për vendsjën e një tabele te ruga kryesore te shkolla fillore 7 marsi që gjdo qytetarë të orientohet për varrezat e dhëshmorëve.

**Bashkim Ndrecaj** –pyet drejtorine e urbanizimit sa leje janë lëshu? ,sa kërkesa kan qenë ,pastaj paraqet shqetësim për zonen industriale,kan fillu me u zgjeru shumë fabrika në atë pjes dhe kafillu ndotja e ambientit, drejtoria e inspeksionit a është t'u ndërmarrë masa.

**Arbërim Basha**-përshëndetje ,drejtorin e arsimit e pyet se sa është numri i nxënësavë që janë regjistruar në klasë të lQta dhe sa paralele janë ,do te thot sipas udhezimit administrativ duhet që në gjimnazin "Jeta e Re "të pranohen 30% të nxënësve pasataj ne shkollën teknike "Skender Luarasi" 35%,dhe 35% në shkollën profesionale "Avdyll Ramaj".Apo përputhën numri i regjistruar me përqindje

**Kryetari**-e mbështes kërkesen e Shefket Kolgecit.

**Remzi Bytyqi**-drejtori i arsimit janë 970 nxanësa ,30% janë të nxënësavë në gjimnaz ,pjesa tjera në shkollat tjera,lQ paralele në gjimnaz.

**Jeton Rrakaqi**-paraqet shqetësim për vërsrshimet dhe dëmet nga breshëri ,a ka nda komuna ndonjë ndihmë dhe pyet drejtorinë e arsimit niveli i testit të maturës në shkollën skendër luarasika qenë mjaft dëshpërues ku është problemi që qëndron ky rez kaq i dobët dhe pse është ajo shkoll qe sa kohë pa drejtor shkollë ,dhe pyet për rrugen e shirokës, kur do të përfundoj.

**Kryetari** –gjatë vërshimeve te fundit që kemi pas ,kanë pas probleme fshatrat,Gelanc ,Tërrnje ,Leshan lagjija e Kicve në Grejkoc rruga e Reqanit,Samadraxha ,Doberdelani,Lagjija Buqve në Budakovë ,masa kemi marr menjëher ,kemi pas një kërkes nga një Nanë ,qe ka pas dëmë dhe komisini ka qenë ,e ka vlersu dëmin e kemi fondin emërgjent për këto probleme,si dhe rruga në shirokë shume shpejt ka me fillu qarkullimi.

**Dardan berisha** –para disa disa kemi kërku nga drejtori i kulturës një interpretim ligjor për themelimin e teatrit dhe tash kërkojmë të dijmë deri ku kan arrit procedurat ligjore dhe drejtoria e bujqesis sa sera i keni montu dhe qfarë kultura bujqësore mund të mbjellim këtë sezon.

**Beqir Berisha**- drejtori i kulturës,ne kemi pranu një kërkes prej nismëtarëve të formimit të teatrit,e kam drejtu te zyrtari ligjor dhe kemi marrë përgjigje se ne nuk kemi drejt pa u formu një grup punues qeveris,jan disa kushte që ne nuk i kemi për themelimin e tij.

**Avni Bytyqi**-jep sqarime mbi kërkesat për themelimin e teatrit.

**Alban Berisha** –a është marrë ndonjë mas ndaj autobusave që ndalen më së paku lQ vende dhe vozitin shumë ngadal.

**Gëzim Kryeziu** –shpreh shqetësim per mosvendosjën të shejave të komunikacionit.

**Takimi përfundoi në ora 15:50  
Proces mbajtësja:  
Dorarta Shabani**